



VENDIM

Nr. 26, Datë 13 / 07 /2017

MBI

PËRCAKTIMIN E PIKËZIMIT NË KONKURSET E PRANIMIT NË NIVERSITETIN E ARTEVE PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018

Senati Akademik i Universitetit të Arteve në mbledhjen e datës 13 / 07 /2017, në zbatim të nenit 38 *Funksionet e Senatit Akademik*, të nenit 74 *Pranimi në ciklin e parë të studimeve*, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nisur nga propozimet e fakulteteve në Universitetin e Arteve, bashkëlidhur këtij vendimi, Senati Akademik i UAR, pasi diskutoi mbi "Mbi përcaktimin e pikëzimit në konkurset e pranimit në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2017-2018",

VENDOSI

- Pikët maksimale për konkurrim në një nga programet e studimit në fakultetet e Universitetit të Arteve të jenë 200 pikë, me këtë ndarje
 - 30 % e totalit ose 60 pikë i takojnë *notës mesatare të viteve të shkollimit dhe provimeve të Maturës Shtetërore*;
 - 70 % e totalit ose 140 pikë i takojnë rezultateve të konkursit të pranimit për secilin program të ofruar nga Universiteti i Arteve;
- Kufiri minimal i pranimit të konkurrentëve të jetë 90 pikë.
- Formula e llogaritjes të pikëve të konkursit të pranimit në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2017-2018, të jetë si më poshtë:
 - P** Pikët e përgjithshme të nevojshme për rankim **200 totali**,
 - NMP** Nota mesatare e përgjithshme ose 30% e barabartë me **60 pikë**,
 - PK** Pikët e konkursit të pranimit ose 70% e barabartë me **140 pikë**,
 - Formula e llogaritjes së pikëve
$$P = (NMP/10 \times 0.3 + PK/140 \times 0.7) \times 200$$
- Vendimi të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve si dhe të dërgohet në formë shkresore në MAS.



Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI  Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA) 

Prof. Dr. Isak SHEHU 

Prof. Petrit MALAJ 


Prof. Asoc. Ardian ISUFI 

Prof. Sadik SPAHIJA 

Prof. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA) 

Prof. Najada HAMZAJ 


Prof. Fatmir MIZIRI 

Prof. Ilir MARTINI 

Prof. Gazmend GJOKA 

Prof. Miltiadh KUTALI 

Prof. Petrika AFEZOLLI 

Prof. Bujar SYKJA 

Prof. Dr. Erald BAKALLI 

Prof. Asoc. Elvis RUDI 

Prof. Asoc. Albes FUSHA 

Nansy GJERAZI 

Rafael HOXHA

Nr. 284 / Prot

Tiranë, më 09.09 2017

DREJTUAR: Rektorit të UA, Prof. Kastriot Çausi
Për dijeni: Zv/Rektorit të UA, Prof. Dr. Erald Bakalli
Lënda: Mbi konkurset e pranimit për vitin akademik 2017-2018

Në zbatim të nenit 74, "Pranimi në ciklin e parë të studimeve", të ligjit nr.8-/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe të shkresës tuaj me nr. 1081/3, dt. 22.06.2017, pas konsultimit me Përgjësëgjisit e Njësive Bazë të Fakultetit propozojmë:

- 1- Pikët maksimale për konkurim në një nga programet e studimit në Fakultetin e Muzikës do të jenë **140 pikë**.
 - a- 30 % e pikëve (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe provimet e maturës shtetërorë)
 - b- 70 % e pikëve (Rezultatet e konkursit të pranimit)
- 2- Kufiri minimal i pranimit të konkurentëve të jetë: **25 pikë**.

DEKANI I FM

Prof. Dr. Isak SHEHU



UNIVERSITETI I ARTEVE



Nr. 342 Prot

Tiranë 28.06.2017

Lënda : Përgjigje shkresës nr 1081/2, datë 22.06.2017 mbi Konkurset e Pranimi për Vitin Akademik 2017 -2018.

Drejtuar : Prof. Kastriot Çausi Rektor UART

I nderuar zoti Rektor !

Në përgjigje të shkresës suaj me nr Prot 1081/ 2, datë 22.06.2017 mbi Konkurset e pranimi në UART për vitin akademik 2017-2018 duke marrë në konsideratë edhe mendimet e përgjegjësve të departamenteve propozojmë si më poshtë:

1- Pikët maksimale në konkurset e pranimi për vitin Akademik 2017- 2018 në të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Artit Skenik të jenë 200 pikë. (Dyqind pikë)

2- Ndarja e pikëve në përqindje të jetë e ndarë në dy zëra si më poshtë :

a- 30 % e pikëve të shumës maksimale (200 pikë) do vinë nga Nota mesatare e viteve të shkollimit të shkollës së mesme dhe Provimeve të maturës Shtetërore,

b- 70 % e pikëve të shumës maksimale (200 Pikë) nga rezultatet e Konkursit

3- Pikët minimale që duhet të marrë një konkurent për t'u pranuar si fitues të jetë 90 pikë

4- Nisur nga totali i pikëve që propozojmë si dhe nga ndarja e përqindjeve të të dy zërave të mësipërm del që pikët maksimale të fituara nga nota mesatare e viteve të studimit të shkollës së mesme dhe provimeve të maturës shtetërore të jenë 60 pikë.

Ndërsa pikët maksimale të fituara nga konkursi i pranimi të jenë 140 pikë

Ju faleminderit !

Në mungesë dhe me porosi të Dekanit të FAS, Prof. Petrit Malaj.

Zv. Dekani i FAS , Prof. Gazmend Gjoka

Nr. 342/11 Prot

Tiranë 28.06.2017

Lënda : Përgjigje shkresës nr. 1081/2, datë 22.06.2017 mbi Konkursët e Pranimit për Vitin Akademik 2017 -2018.

Drejtuar : Prof. Kastriot Çausi Rektor UART

I nderuar zoti Rektor !

Në përgjigje të shkresës suaj me nr Prot 1081/ 2, datë 22.06.2017 mbi Konkursët e pranimit në UART për vitin akademik 2017-2018, duke marrë në konsideratë edhe mendimet e përgjegjësve të departamenteve propozojmë si më poshtë:

1- Pikët maksimale në konkursët e pranimit për vitin Akademik 2017- 2018 në të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Artit Skenik të jenë 200 pikë. (Dyqind pikë)

2- Ndarja e pikëve në përqindje të jetë e ndarë në dy zëra si më poshtë :

a- 30 % e pikëve të shumës maksimale (200 pikë) do vinë nga Nota mesatare e viteve të shkollimit të shkollës së mesme dhe Provimeve të maturës Shtetërore,

b- 70 % e pikëve të shumës maksimale (200 Pikë) nga rezultatet e Konkursit

3- Pikët minimale që duhet të marrë një konkurent për t'u pranuar si fitues të jenë 90 pikë

4- Nisur nga totali i pikëve që propozojmë si dhe nga ndarja e përqindjeve të të dy zërave të mësipërm del që pikët maksimale të fituara nga nota mesatare e viteve të studimit të shkollës së mesme dhe provimeve të maturës shtetërore të jenë 60 pikë.

Ndërsa pikët maksimale të fituara nga konkursi i pranimit të jenë 140 pikë

Ju faleminderit !

Përgjegjësi i Njesisë Bazë Skenografi –Koreografi, Prof. Ilir Martini

Përgjegjësi i Njesisë Bazë Aktrim –Teori Arti, Prof.Asoc.Dr.Elida Rapti

Përgjegjësi i Njesisë Bazë Regji – Regji Filmi & TV Prof. Miltiadh Kutali

Në mungesë dhe me porosi të Dekanit të FAS, Prof. Petrit Malaj.

Zv. Dekani i FAS , Prof. Gazmend Gjoka.



Nr. 6 Prot

Tiranë, më 27.06.2017

Drejtuar: Rektorit të UA, Prof. Kastriot Çausi

Për dijeni: Zv/Rektorit të UA, Prof. Dr. erald Bakalli

Lënda: Mbi konkurset e pranimit për vitin akademik 2017-2018

Në zbatim të nenit 74, "Pranimi në ciklin e parë të studimeve", të ligjit nr.8-/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe të shkresës tuaj me nr. 1081/3, dt. 22.06.2017, pas konsultimit me Përgjeshëgjist e Njësive Bazë të Fakultetit propozojmë:

- 1- Pikët maksimale për konkurim në një nga programet e studimit në FAB të jenë **200 pikë**
 - a- 30 % e pikëve (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe provimet e maturës shtetërorë)
 - b- 70 % e pikëve (Rezultatet e konkursit të pranimit)
- 2- Kufiri minimal i pranimit të konkurentëve të jetë: **90 pikë**.

DEKANI I FAB

Prof. Asc. Ardian ISUFI



UNIVERSITETI I ARTEVE